



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 1447 prot

Vlorë, 19.09.2024

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2024

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS PËR FËMIJËT E FAMILJEVE QË KANË NEVOJË
PËR KOPSHT DHE ÇERDHE, PËRFITUES TË PROGRAMIT TË QENDRËS
PSIKO-SOCIALE “VATRA”**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b, neni 24 , neni 30 pika 7 dhe neni 54 pika k dhe n , në Ligjin Nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 pika b dhe neni 6, ne Ligjin 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB Nr.1 pika b datë 29.01.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën dhe nga fondet e Buxhetit Vendor”, si dhe në bazë të materialit të paraqitur nga Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, për Këshillin e Bashkisë:

V E N D O S I:

- 1.Të frekuentojnë kopshtin me drekë 1 fëmijë.
 - 2.Të frekuentojnë çerdhen me drekë 3 fëmijë .
- Gjithsej 4 fëmijë, familjet e të cilëve janë përfitues të programit të Qendres Psiko-Sociale “Vatra”.
- 3.Frekuentimi i fëmijëve në këto institucione të trajtohen për një periudhë 6 mujore.
 - 4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social .

	EMËR ATËSI MBIEMËR	Përshkrimi i gjendjes socio - ekonomike
1	Armando Fran Marku	Lindur në Shkodër më 02.02.2020 i biri i Dukate Bushgjoka dhe Fran Markut. Aktualisht i mituri është i strehuar pranë Strehezës së Qendrës Psiko-Sociale “Vatra” sëbashku me nënën dhe motrën e tij, te cilët marrin shërbime riinteguese në Qendern Vatra. Nëna është “viktimë e dhunës në marrëdhënie familjare”. Qendra “Vatra” kërkon mbështetjen e Bashkisë Vlorë për ti siguruar të miturit përfitimin falas të kopshtit me drekë.
2	Jasmin Ledion Mankaj	Lindur në Vlorë më 29.08.2023 e bija e Enkelejda Rrapaj dhe Ledion Mankaj. Aktualisht e mitura është e strehuar pranë Strehezës së Qendrës Psiko-Sociale “Vatra” sëbashku me nënën e saj. Enkelejda është e identifikuar si “Viktimë e mundshme trafikimi” dhe më parë ka qënë “viktimë e dhunës në familje”. Qendra “Vatra” kërkon mbështetjen e Bashkisë Vlorë për ti siguruar të miturës përfitimin falas të akomodimit në çerdhe.
3	Luella Eduart Ali	Lindur ne Vlorë më 13.03.2022 e bija e Eliona dhe Eduart Ali. Nena eshte “viktimë e mundshme e trafikimi” dhe me parë ka qënë “viktimë e dhunes ne familje”. Përfituesja është asistuar në marrjen e urdherit të mbrojtjes dhe do të asistohet në çështjen familjare me objekt “zgjidhje martesë”, lënien fëmijëve në “rritje dhe edukim”, si dhe shërbimet rezidenciale pranë Strehezës së Qendrës “Vatra”. Kërkohet mbështetja e Bashkisë Vlorë për ti siguruar të miturës përfitimin falas të akomodimit në çerdhe.
4	Elumeda Eduart Ali	Lindur ne Gjirokaštër më 09.02.2024 e bija e Eliona dhe Eduart Ali. Nëna është “viktimë e mundshme trafikimi” dhe më parë ka qënë “viktimë e dhunës në familje”. Përfituesja është asistuar në marrjen e urdherit të mbrojtjes dhe do të asistohet në çështjen familjare me objekt “zgjidhje martesë”, lenien femijeve ne “rritje dhe edukim”, si dhe shërbimet rezidenciale

		pranë Strehzës së Qendrës “Vatra”. Kërkoet mbështetja e Bashkisë Vlorë për ti siguruar të miturës përfitimin falas të akomodimit në çerdhe.
--	--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b .

Konceptoi: K.Billa
Pranoi I.Stasa
Miratoi: O.Durulli
Konfirmoi: D.Demiri

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION
mbi
PROJEKTVENDIMIN
Për

**Miratimin e listës për fëmijët e familjeve që kanë nevojë për kopësht dhe çerdhe,
përfitues të programit të Qëndres Psiko-Sociale “Vatra”**

Pranë Bashkise Vlorë është depozituar një kërkesë në muajin Gusht 2024 nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra” për mbështetjen e katër fëmijeve të familjeve “viktima të dhunës në mardhenie familjare” dhe “viktima të trafikimit të qenijeve njerzore”.

Qendra Psiko-Sociale “Vatra” e cila mbështet me shërbime mbrojtje, rehabilituese dhe riintegruese “viktimat e dhunës në mardheniet familjare” “viktimat e trafikimit të qenijeve njerzore”, “viktimat e abuzimit seksual” dhe format e tjera të dhunës. Pranë Qendra Psiko-Sociale “Vatra” gjate vitit 2024 janë trajtuar me shërbime multi-disiplinare rastet e familjeve te katër fëmijeve të cilët kanë nevojë për mbështetje për akomodimin e tyre në çerdhe dhe kopsht falas.

Konceptoi: K.Billa

Drejtor i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social

Irena Stasa